



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Smart Eng Group” Sh.P.K. të datës 04.03.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës 20.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i objektit të vjetër dhe objektit të ri të Komunës si dhe bashkësive lokale” me nr. të prokurimit 616-24-1233-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Smart Eng Group” Sh.P.K. e datës 04.03.2024 kundër njoftimit për kontratë të datës 20.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i objektit të vjetër dhe objektit të ri të Komunës si dhe bashkësive lokale” me nr. të prokurimit 616-24-1233-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Smart Eng Group” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Smart Eng Group” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 04.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 20.02.2024 për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i objektit të vjetër dhe objektit të ri të Komunës si dhe bashkësive lokale” me nr. të prokurimit 616-24-1233-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Të paknaqur me kërkesat e AK Kuvendi Komunal Prishtinë, për këto aktivitete të prokurimit, kërkojmë nga AK që disa nga kërkesat në FDT të ndryshohen sepse ne mendojmë që kërkesat e tilla janë bërë me qëllim të zvogëlimit të konkurrencës dhe favorizimit të një operatori të caktuar. Tek kërkesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 2. OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional si në vijim 1. Një inxhinier I diplomuar I ndërtimtarisë (drejtimi Konstruktiv) me 5 vite përvojë pune pas diplomës, i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë. Të jetë menaxher I projektit -Inxhinier apo master Arkitekturës me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomës, Një inxhinier apo master Elektroteknikës me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomës, Një inxhinier I ndërtimtarisë apo master drejtimi hidroteknike me minimum vite përvojë pune pas diplomës, - Një inxhinier i makinerisë me minimum 5 vite përvojë pune- drejtimi. 3. Staf i teknik - Një (1) puntor i certifikuar për hidroizolime, Një (1) murator, Një (1) teknik I elektros i certifikuar programin e efikasitetit të energjisë, Një (1) saldues i certifikuar - 1, Një teknik I ndërtimtarisë - Një (1) shtrues pllakash; - Një (1) hidroinstalues, - Një zdrukthtar - Se paku 8 punëtor të certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 7. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 të DT. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL: 1. 1. Se paku një kamion me kran dhe kiper me peshe bartese min 2 ton, 1 cope 2. 2. Se paku një makinë për ngjyrosje 1 cope 3. 3. Se paku një makinë për grryerjen e gletit 1 cope 4. 4. Se paku 2000 m² skele m² 5. 5. Gypa për largimin e materialeve të emoluar min 20 m m 6. 6. Se paku një makine për ngjyrosje 1 cope 7. Se paku dy kamioneta 2 cop Disa kritere janë vendosur për ta favorizuar një kompani të caktuar. Një Teknik I elektros I certifikuar për efikasitet të energjisë, (I certifikuar mundet të jetë edhe ing I elektros, por ju e keni specifikuar një Teknik që është diskriminues”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve. Me këtë rast njësi kërkuese ka konfirmuar se të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit janë në përputhje të plotë me nevojat e njësisë kërkuese dhe qëllimin e prokurimit. Si të tilla këto kërkesa janë hartuar me kujdes, në mënyrë profesionale dhe në përputhje të plotë me LPP dhe RRPP duke përfshirë këtu edhe nenin 7 të LPP respektivisht parimin për mosdiskriminim dhe mosfavorizim të operatorëve ekonomik. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.03.2024

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.